

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Vahid Halili, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti e Fillim Skoro, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarve A.K, M.B dhe V.H, për shkak të veprës penale detyrimi nga neni 314 par.2 lidhur me par.1 të KPK-se, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit A.K, av.B.C, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Peje P.nr.146/15 të date 23.09.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 18 shkurt 2016, mori këtë ;

AKT GJYKIM

REFUZOHET si e **pabazuar** ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.K, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Peje P.nr.146/15 të datës 23.09.2015 **VERTETOHET**.

Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Peje **P.nr.146/15** të datës 23.09.2015, të akuzuarit A.K, M.B dhe V.H janë shpallur fajtor për veprën penale detyrimi nga neni 340 par.2 lidhur me par.1 të KPK-se, për të cilën u janë shqiptuar dënimet me burg dhe me gjobe dhe atë A.K është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 30.04.2015 deri me date 23.09.2015 si dhe me dënim me gjobe në shume prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) Euro e të cilën gjobe është obliguar të paguaj në afat prej 3 (tre) muaj pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, në rast se nuk e paguan të njëjtën dënim me gjobe do t'i zëvendësohet me dënim burgu duke i llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzet) Euro gjobe.

I akuzuari M.B është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 30.04.2015 deri me date 30.07.2015 si dhe me dënim me gjobe në shume prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) Euro e të cilën gjobe është obliguar të paguaj në afat prej 3 (tre) muaj pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, në rast se nuk e paguan të njëjtën dënim me gjobe do t'i zëvendësohet me dënim burgu duke i llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzet) Euro gjobe.

I akuzuari V.H është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 30.04.2015 deri me date 30.07.2015 si dhe me dënim me gjobe në shume prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) Euro e të cilën gjobe është obliguar të paguaj në afat prej 3 (tre) muaj pas plotfuqishmërisë së

aktgjykimit, ne rast se nuk e paguan te njëjtin dënimi me gjobe do t'i zëvendësohet me dënim burgu duke i llogaritur një dite burgim me 20 (njëzet) Euro gjobe.

Te akuzuarit janë obliguar qe t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale ne shume prej nga 75 (shtatëdhjetë e pese) Euro secili veç e veç si dhe paushallin gjyqësor ne shume prej nga 25 (njëzet e pese) Euro , e te gjitha këto ne afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Te akuzuarit gjithashtu janë obliguar qe te dëmtuarit A.B, t'ia kompensojnë demin e shkaktuar ne shume prej 1000 (njëmijë) Euro ne mënyrë solidare ne afat prej 3 (tre) muajve pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, ne afatin ligjor ka ushtruar ankese mbrojtësi i te akuzuarit A.K, av.B.C, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e ankimuar te gjykatës se shkalles se pare ta ndryshojë dhe të akuzuarit të i shqiptoje një dënim me te ulet me burg dhe me gjobe e me te cilin do te arrihet qëllimi i dënimit i parapare me nenin 41 te KPRK-se.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit te akuzuarit A.K-av.B.C, me shkresën e vet PPA/I.nr.580/15 të datës 21.12.2015, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit te akuzuarit te refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare te **VERTETOHET**.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e mbajti konform dispozitës se nenit 390 par.1 te KPPRK-se, ne te cilën prezantoi vetëm prokurori i apelit ndërsa palët e tjera munguan edhe pse te njoftuar ne mënyrë te rregullt, andaj seanca e kolegjit u mbajt konform nenit 390 par.4 te KPPRK-se. Prokurori i Apelit propozoi qe ankesa e mbrojtësit te akuzuarit A.K te refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit, pasi i shqyrtoi te gjitha shkresat e çështjes penale, studioi aktgjykimin e ankimuar ne pajtim me dispozitën e nenit 394 par.1 te KPPK-se dhe pas vlerësimit te pretendimeve te cekura ne ankese gjeti se

-Ankesa nuk eshte e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkalles se pare nuk ankimohet per shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës te njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe ne këtë aspekt konform dispozitës se nenit 384 te KPPRK-se dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale dhe as shkelje te ligjit penal ne dem te akuzuarit te cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja e fakteve nuk ka qene objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase as me ankese nuk ka mundur te kontestohet sepse i akuzuari ne shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për te gjitha pikat e akuzës dhe trupi gjykues si dhe prokuroria është pajtuar me një

pohim te tille ngase i njëjti është bere pas konsultimit me mbrojtësin e tij dhe ka mbështetje ne provat te cilat gjenden ne shkresat e lendes, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm ne drejtim te pretendimeve ankimore lidhur me vendimin mbi sanksionin penal.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin për dënim, Gjykata e Apelit e Kosovës gjeti se pretendimet ankimore te mbrojtësit te akuzuarit A.K nuk qëndrojnë.

Mbrojtësi i te akuzuarit me ankese pretendon se dënimi i shqiptuar te akuzuarit është i larte duke e patur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, është penduar për veprën penale te kryer, se është hera e pare qe ndeshet me ligjin dhe se nuk ka dosje kriminale, ka kushte te vështira ekonomike, është i papune e duke i patur parasysh edhe rrethanat lehtësuese te cilat gjykata e shkalles se pare i ka konstatuar atëherë konsideron se qe gjykata te akuzuarit duhet te i shqiptoj me te ulet me burg dhe me gjobe. Sipas vlerësimit te Gjykatës se Apelit, duke patur parasysh rrethanat e cekura me larte, rrethanat e rastit konkret, mënyrën e kryerjes se veprës penale kjo gjykate konsideron se dënimet e shqiptuara te akuzuarit janë ne harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore te veprës penale dhe me shkallen e përgjegjësisë penale te akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar është ne funksion te parandalimit te kryesit nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen, te bej rehabilitimin e tij si dhe te ndikoje edhe ne personat e tjerë qe te mos kryejnë vepra penale, duke konsideruar se me dënimet e shqiptuar si ne dispozitiv te aktgjykimit te ankimuar do te arrihet qëllimi i dënimit i parapare me dispozitën e nenit 41 te KPK-se.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit te Procedurës Penale të Kosovës u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.610/15, Më 18.02.2015

Procesmbajtësi
Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,
Vahid Halili

Fillim Skoro
